



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
-AUTORITETI I KONKURENCËS-

Njoftim paraprak përqendrimi

Rasti: Përfitim kontrolli Geo Jade Petroleum Corporation – Bankers Petroleum Ltd.

Në datën 14 Prill 2016, Autoriteti i Konkurrencës ka marrë njoftimin e transaksionit të realizuar në bazë të “Marrëveshje organizimi” i nënshkruar midis Charter Power Investment Limited (Mëma e Blerësit), 1958082 Alberta Ltd (Blerësi) dhe Bankers Petroleum, më datë 19 Mars 2016, me objekt përfitim të kontrollit te plotë dhe të vetëm, nga Geo Jade Petroleum Corporation të Bankers Petroleum Ltd. (Targeti), me anë të përfimit të të gjithë kapitalit aksionar në këtë të fundit.

Veprimtaria e palëve pjesëmarrëse:

- **Geo Jade Petroleum Corporation:** një shoqëri e aksionare e me ofertë publike e organizuar sipas legjislacionit të Republikës së Kinës. Shoqëria është aktive në kërkim-zhvillimin e naftës dhe të gazit;
- **Bankers Petroleum Ltd.:** është një shoqëri që funksionon në bazë të legjislacionit Kanadez dhe me veprimtari të kërkimit dhe prodhimit të gazit dhe naftës në Shqipëri. Në Shqipëri shoqëria vepron me anë të dy degëve të saj BANKERS Petroleum Albania Ltd. dhe Sharewood Petroleum Ltd.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se transaksioni i njoftuar është në përputhje me nenet 10, pika 1, shkronja b), 12, pika 1) të Ligjit.

Autoriteti fton palët e interesuara të shprehin opinionet e tyre për transaksionin e njoftuar. Opinionet duhet të paraqiten jo më vonë se 15 ditë nga publikimi i këtij njoftimi.

Opinionet mund të dërgohen pranë Autoritetit të Konkurrencës me fax (nr 0355 4 2234 497), me postë në adresën: Autoriteti i Konkurrencës, Rr “Sami Frashëri”, Nr 4, Kati IV Tiranë; apo me e-mail në adresën competition@caa.gov.al